



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:089767  
Datë: 16.05.2024  
Numri i dokumentit: 05696021

Pml.nr.131/2024

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Memaj, kryetare e kolegjit, Rasim Rasimi dhe Agim Maliqi, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të dënuarit E. M., për shkak të veprës penale vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit, av. Naim Rudari, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.261/2018 të datës 31.5.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr.395/2023, të datës 8.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 24.4.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit E. M., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.261/2018 të datës 31.5.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr.395/2023, të datës 8.11.2023.

**A r s y e t i m i**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.261/2018 të datës 31.5.2023, i dënuari E. M., është shpall fajtor për shkak të veprës penale vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK dhe ndaj të njëjtit është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) vitesh, i cili dënim do të ekzekutohet pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, në dënimin e shqiptuar të dënuarit do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 21.2.2018 e deri me datën 21.3.2018 dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak, prej datës 21.3.2018 e deri me datën 25.5.2018 si dhe dënimi me gjobë në shumë prej 300€ (treqind euro). Ndërsa G. M., për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 par. 1 të KPRK, është shpallur fajtorë dhe i është shqiptuar dënimi gjobë në shumë prej 500€ (pesëqind euro). Janë detyruar që secili veç e veç, që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej njëqind (100) Euro, si dhe të paguajë shumën prej pesëdhjetë (50) Euro në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PAKR.nr.395/2023, e datës 8.11.2023, i ka refuzuar si të pabazuara ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar si dhe ankesën e mbrojtësit të të dënuarit E. M., ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit E. M., av. Naim Rudari, për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale që kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësorë, me propozimin që kërkesa të aprovohet si e bazuar, ndërsa këto aktgjykime të anulohen dhe kjo çështje penale të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.75/2024 e datës 1.3.2024 ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi i shqyrtojë shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPP dhe pasi i vlerësojë pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

- kërkesa është e pabazuar.

Mbrojtësi i të dënuarit, në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë thekon se i dënuari nuk e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, ndonëse nuk është kontestuese se ai e ka përdorur armën e gjuetisë, e punuar në mënyrë artizanale, të cilën e ka mbajtur në atelienë e tij artistike. Dashja dhe qëllimi janë rrethana të cilat nuk mund të nxirren dhe të vërtetohen me prova konkrete, por i dënuari ka deklaruar qartë se nuk ka pasur qëllim që ta vrasë e as të lëndoj të dëmtuarin, ai ka gjuajtur në anën e djathtë të të dëmtuarit ku edhe i ka shkaktuar lëndim në dorë, dhe se nga afërsia 1-1.5 metër ka mundur që ta qëllojë në bark dhe se ka mundur të gjuajë sërish por ai nuk ka pasur qëllim vrasjen e të dëmtuarit e as shkaktimin e ndonjë pasoje tjetër

më të vogël se vrasja. I dënuari dhe familja e tij ndiejnë keqardhje për lëndimet që i janë shkaktuar të dëmtuarit nga veprimi i pamatur i të dënuarit. Nuk janë dhënë arsye për faktet vendimtare në të cilat mbështetet aktgjykimet. Veprimet e tij mund të përbëjnë veprën penale të lëndimit trupor por assesi vrasje në tentativë, ngase ai nuk ka pasur motiv, nuk ka pasur qëllim e as dashje që të kryejë atë vepër penale, madje as nuk ka pasur qëllim që ta lëndojë të dëmtuarin, por i tërë qëllimi ka qenë që ta frikësojë të njëjtin dhe ta largojë nga aty. Mbrojtësi më tej përshkruan gjendjen faktike duke e kontestuar atë, deklaratat e dëshmitarëve, të ekspertëve, etj. Në shkresa të lëndës nuk është qartësuar se i dëmtuari a është person i qetë dhe i urtë apo lehtë i largueshëm nga kacafytja. Familja M. vetë ka insistuar që të evitohet mosmarrëveshjet dhe të gjejnë një gjuhë mirëkuptimi me të dëmtuarin por përkundër përpjekjeve të vazhdueshme nuk kanë arritur ta bëjnë një gjë të tillë.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi i shikoi shkresat e lëndës dhe analizoi pretendimet e mbrojtësit të dënuarit E. M., konstatoi se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë, nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as me shkelje të ligjit penal, siç pretendohet në kërkesë, dhe si aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë, ashtu edhe aktgjykimet e gjykatës së shkallës së dytë janë përpiluar në formën e parashikuar me ligj, pasi që përmbajnë të gjitha elementet që kërkohen sipas dispozitave përkatëse ligjore, si në pjesën e dispozitivit, ashtu edhe në pjesën e arsyetimit.

Dispozitivi i këtyre aktgjykimeve është i qartë i kuptueshëm dhe konkret dhe nuk është në kundërshtim me vetveten dhe është në harmoni dhe në përputhshmëri të plotë me arsyetimin dhe gjithashtu edhe përpilimi i dispozitivit dhe i tërë aktgjykimit është bërë konform dispozitave të nenit 369 lidhur me nenin 364 të KPP, ku janë të përfshira të gjitha faktet dhe rrethanat konkrete përkitazi me ngjarjen kritike, fakte dhe rrethana këto nga të cilat plotësohen të gjitha elementet e veprës penale vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK, për të cilat tani i dënuari është shpallur fajtorë. Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të detajuar e ka bërë vlerësimin e të gjitha deklaratave nga shkresat e lëndës dhe se çështjen penale e ka gjykuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Gjykata e shkallës së parë, vlerësimin e provave e ka bërë në pajtim me dispozitat e nenit 360 të KPP, kurse për provat kontradiktore ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 369 par. 7 të KPP, duke paraqitur në mënyrë të plotë dhe të qartë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i merr si të provuara ose të paprovuara, gjithashtu ka dhënë arsye të qarta për vendin, kohën, mënyrën e kryerjes së veprave penale.

Aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë janë të qëndrueshëm, rrethanat e paraqitura në aktgjykime janë të qarta dhe në përputhje me dispozitat ligjore që nënshtrohen saktësisht veprave penale për të cilat i dënuari është shpallur fajtorë dhe është dënuar.

Po ashtu edhe pretendimet e mbrojtësit të dënuarit lidhur me shkeljen e ligjit penal janë të pabaza, ngase edhe ligji penal është aplikuar drejtë, kur në veprimet e të dënuarit është

konstatuar se qëndrojnë elementet e veprave penale vraje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK, pasi që gjykata e shkallës së parë nga të gjitha provat materiale të administruara në shqyrtimin gjyqësor, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë faktin se natën kritike (me datën 21.02.2022), pasi që i dëmtuari përshëndetet me dy dëshmitarët – ndërmjetësuesit (të cilët me kërkesën e familjes së të akuzuarit kanë shkuar në familjen e të dëmtuarit për të arritur marrëveshje për parkimin e veturave), dhe pasi i dëmtuari ka bërë dy tre hapa në drejtim të shtëpisë së tij, në atë moment përnjëherë ka dal i akuzuari E. nga dyert e oborrit të tij, me armë në dorë, pushkë gjuetie e punuar me dorë e kalibrit 16 bore dhe duke shtënë nga distanca prej 1 m - 1.5 m, në drejtim të të dëmtuarit, me dashje që ta privojë nga jeta e qëllon të dëmtuarin duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore, të cilat janë vërtetuar nga raporti i ekspertizës mjeko – ligjore (ku janë konstatuar lëndimet si vrimë-plagë me armë zjarri në bark majtas dhe amputim total në nyje distale (mungesë komplet e gishtave pjesën distale) e gishtave 3 dhe 4 të shuplakës së dorës së majtë, të shkaktuara nga ndonjë predhë e hedhur nga arma e dorës – zjarrit (ku u gjete edhe predha nën lëkurë majtas në regjionin e barkut), tregojnë qartë motivin, dashjen dhe qëllimin e tij për të privuar nga jeta të dëmtuarin, të cilin konstatim si të drejtë e pranon edhe kjo Gjykatë dhe se gjykatat drejtë kanë gjetur se i dënuari ka qenë penalisht përgjegjës, ka poseduar aftësi intelektuale dhe volitive që e bëjnë të mundshme të mendoj, gjykoj, vendos dhe ti kontrollojë veprimet e tij inkriminuese, i vetëdijshëm për rëndësinë dhe pasojat e veprës penale të rrezikshme dhe të kundërligjshme.

Deri sa pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit se ai ka gjuajtur në anën e djathtë të të dëmtuarit ku edhe i ka shkaktuar lëndim në dorë, dhe se nga afërsia 1-1.5 metër ka mundur që ta qëllojë në bark dhe se ka mundur të gjuajë sërish por ai nuk ka pasur qëllim vrasjen e të dëmtuarit e as shkaktimin e ndonjë pasoje tjetër më të vogël se vrasja, por vetëm lëndim trupor, janë pretendime të një anshme për t'u munduar për t'i ikur përgjegjësisë penale.

Nga përmbajtja e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë rezulton se aktgjykimet kundërshtohen edhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, bazuar në nenin 432 par. 2 të KPP, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Andaj, nga arsyet e cekura më lart dhe në bazë të nenit 437 të KPP është vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.131/2024, më datë 24.4.2024

Bashkëpunëtorja profesionale,  
Qefsere Berisha

Kryetare e kolegjit,  
Mejreme Memaj